



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

**Procesverbal**

**Konsultim publik :**

**Data :** 26/03/2026 **Ora :** 12:00

**Vendi:** Salla e Këshillit

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 17 persona të pranishëm

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** “ Miratimin e çmimit maksimal ditor për shfrytëzimin e setit çadër plazhi +2 shezlog , në plazhin e Bashkisë Pogradec nga subjektet private që ushtrojnë veprimtari sitacion plazhi”

**Pjesëmarrës :**

Alma Kanina ( Drejtore Kabineti)

Anxhela Pilinci ( Drejtoresha e Taksave)

Klajdi Gjona ( Këshilltar)

Vjollca Pllaha ( Këshilltare )

**Znj. Pilinci:** Përshëndetje! Çmimi tavan për Shezlog-ët duhet të vendoset nga cdo Bashki, për këtë arsye ne po bëjmë konsultimin publik për të vendosur të gjithë bashkë. Pjesëmarrës duhet të ishin më shumë, por gjithsesi ne do diskutojmë. Nga Kryetari i Bashkisë u tha që çmimi tavan të ishte 700 lekë dhe në plazhet publike asnjë ndryshim. Po pres mendimet tuaja.

**Z. Petrit Tasellari:** Unë mendoj që çmimi është në rregull.

**Znj. Shuli:** Unë mendoj tek 1000 dhe secili të zgjedhë vetë çmimin që do mbajë. Në fundjavë mund të shfrytëzohet. Pogradeci nuk ka shumë verë, ne shfrytëzojmë vetëm një muaj të verës.

**Z. Tasellari:** Nuk e paguan njeri këtë çmim. Raporti kërkesë-ofertë ndryshon brenda ditës, edhe ata që kanë mundësi, po prapë ne kemi qenë që ju kemi mësuar që në Pogradec bëhen pushime të lira.

**Z. Artan:** Pritshmëritë janë edhe më të shumta.

**Znj. Shuli:** Në fundjavë edhe mund ta vendosim.

**Znj. Pilinci:** Mendimi që unë jap është të diskutoni me njëri-tjetrin dhe të gjithë të jeni në një mendim.

**Z. Tasellari:** Problemi është që tek ne kështu funksionon. Ne i kemi mësuar dhe nuk mund ta vendosim, por edhe sikur, ndryshon gjatë muajve.

**Z. Gjona:** Sa kosto keni ju për shezlonët?

**Z. Artan:** Normal që ka kosto dhe mund të them që kostoja është goxha e lartë.

**Znj. Pilinci:** Normale që ka kosto, por edhe ne si Bashki ju kemi ndihmuar shumë. Pagesa që bëhet për 60 ditë, ne e kemi lënë për 45 ditë, duke e ditur që qyteti ynë nuk ka një sezon veror të plotë.

**Z. Artan:** Po, keni të drejtë, nuk bëhet llogaritja 100%.

**Znj. Pilinci:** Ne e kemi toleruar, sepse muaji qershor edhe muaji korrik është i vakët. Ne bëmë një kërkesë ku qyteti i Pogradecit të hyjë ndryshe, duke e ditur që nuk kemi të njëjtin sezon si qytetet e tjera dhe na i pranuan. Aplikuesit do kenë të drejtë të marrin vetëm 50 çadra, përveç bizneseve të mëdha. Këtë vit kanë të drejtë të aplikojnë edhe bizneset e tjera që nuk janë hotele. Do ju lutesha që çdo kush të ketë vrojtuesit e plazhit, është shumë e rëndësishme.

**Znj. Shuli:** Do ju lutesha që të mos ketë një vrojtues çdo biznes.

**Znj. Pilinci:** Këtë mund ta zgjidhni me njëri-tjetrin, që të jetë një vrojtues për disa biznese. Duhet të keni parasysh rrethimin me bova dhe pikën e vrojtimit.

**Z. Manol:** Unë mendoj që çmimi tavan të vendoset 1000 dhe çdokush të vendosë si e mendon.

**Znj. Pilinci:** Ne do e propozojmë te Kryetari, por pjesa e çmimit nuk është bërë për ne, është bërë për jugun, por ne jemi të detyruar ta zbatojmë. Tek ne nuk ka abuzim.

**Z. Gjona:** Pjesa e plazhit falas nuk ju konkurren.

**Z. Manol :**Ajo pjesë nuk na konkurren, se të gjithë duhet të bëjnë plazh, jo të gjithë kanë mundësi.

**Z. Tasellari:** Atje ku operoj unë i kam mbajtur të gjitha unë, edhe pastrimin. Po patët mundësi,të vendosim disa kosha.

**Znj. Pilinci:** Vuajmë nga kjo pjesë. Koshat e mëdhenj janë mbrapa pallateve. Kur është bërë kontrata, ku çdo biznes duhet të ketë koshat e vet.

**Znj. Pilinci:** Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe për diskutimet.

**Protokolloi : Suela Mertkola**

**SEKRETARE E KËSHILLIT**

**Jona BOJKO**